

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e VIII-të e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë,
mbajtur më 31.07.2014

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:08.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Agim Bregaj, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatime Haziri, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Ismet Gashi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani, dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit - apeloj që të mos votohet rendi i ditës, me arsyetimin se nuk i ka shkuar në shtëpi materiali për mbledhjen e KK-së.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin e qytetarëve që ditëve të fundit ka ndërprerje të shpeshtë të furnizimit me energji elektrike, dhe arsyet nuk dihen. Po ashtu tha se situatë edhe më e rëndë është shtrenjtimi i rrymës në këtë kohë kur është gjendja e rëndë ekonomike dhe kur akoma nuk janë konstituuar institucionet qendrore, prandaj kërkoi që Kuvendi i komunës të shpreh shqetësimin dhe reagimin e vet lidhur me këtë gjendje para institucioneve kompetente, në mënyrë të që marrin masa për furnizim cilësor me energji elektrike dhe të mos ketë ndërprerje të saj.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që pika nr. 5 e rendit të ditës të hiqet, pasi që nuk është respektuar rekomandimi dhe qëndrimi unanim i anëtarëve të KPF-së që për mbledhjen e kuvendit të procedohet raporti i shkoqitur tremujor për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: prill, maj dhe qershor 2014, duke shtuar se është edhe obligim ligjor që kryetari i komunës të raportojë pas çdo tre muaji për të hyrat vetanake dhe shpenzimet komunale. Pastaj kërkoi informatë nga kryetari i komunës rreth dëmtimeve të shtëpive dhe të lënduarve eventual si rezultat i motit të lig që ka ndodhur një ditë më parë.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- iu bashkëngjiti shqetësimit të M.Shabanit lidhur me ndërprerjet e shpeshta dhe shtrenjtimin e energjisë elektrike. Pastaj tha se gjithë konsumatorët e energjisë elektrike të Vushtrrisë janë në kategorinë C, përveç spitalit, shkollës së policisë dhe një numri i vogël i bizneseve, prandaj shtoi se nuk beson që Komuna e Vushtrrisë nuk i kryen obligimet dhe nuk bën pagesë, prandaj nuk e meritojnë që të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë të jenë në kategorinë C, duke e konsideruar këtë si veprim, si një diskriminim, dhe për këtë arsye kërkoi që të pyetet KEDS-i pse e gjithë Vushtrria gjendet në kategorinë C.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - sqaroi se për shkak të periudhës së shkurtë kohore, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, nuk ka pasur mundësi të implementojë rekomandimin e KPF-së për procedim të raportit të shkoqitur tremujor, prandaj kërkoi nga anëtarët e kuvendit që kësaj radhe të procedohet në formën siç u është dërguar, kurse në herët tjera do të procedohet ashtu siç kanë kërkuar anëtarët e KPF-së.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar shqetësimeve të ngritura nga anëtarët e KK-së, sqaroi me sa vijon: javën e kaluar ka realizuar takim me përfaqësuesit e KEDS-it, ku në takim janë ngritur dhe debatuar të gjitha shqetësimet që i ka qyteti dhe banorët e Vushtrrisë (ku në mesin e atyre shqetësimeve hyjnë edhe shqetësimet e ngritura sot nga anëtarët e KK-së), dhe shtoi se shtrenjtimi i rrymës përveç që ndikon negativisht në ekonominë familjare, ndikon edhe në zhvillimin ekonomik në tërë komunën; gjatë natës së mbrëmshme moti i lig e ka përfshirë një pjesë të fshatit Studime e Poshtme, pjesën lindore të qytetit të Vushtrrisë, si dhe fshatrat: Gojbulë, Karaçë, Shilovicë dhe Tërllobuq, në ç'rast ua ka hequr shumë tjegulla të shumë çative, kurse janë lënduar dy persona, si dhe janë dëmtuar shumë shtylla elektrike, duke shtuar se kanë intervenuar menjëherë njësi të zjarrfikësve dhe policia, dhe si rezultat i kësaj gjendjeje, në cilësinë e kryetarit të komunës ka formuar një komision, i cili është duke konstatuar gjendjen reale të dëmeve në terren.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi me 25 vota "për", 9 "kundër", miratoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 26.06.2014.
2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 17.07.2014.
3. Shqyrtimi i draft-rregulloreve (shqyrtimi i dytë):
 - a) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.
 - b) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.
 - c) Për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.
4. Shqyrtimi i Draft-Planit komunal i veprimt për eficiencë të energjisë për periudhën 2014-2020 (shqyrtimi i dytë).
5. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: prill, maj dhe qershor 2014.
6. Njoftimi i anëtarëve të KK-së lidhur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2013.
7. Shqyrtimi i informatës lidhur me përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Vushtrrisë.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kritereve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.
10. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).
11. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 (shqyrtimi i parë).
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione.
14. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e KK-së, mbajtur më 26.06.2014.

Aprovohet me 34 vota "për", 1 "kundër" procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

2. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e KK-së, mbajtur më 17.07.2014.

Aprovohet me 34 vota "për", 1 "abstenim" procesverbali në fjalë, pa vërejtje dhe sugjerime.

3. Shqyrtimi i draft-rregulloreve (shqyrtimi i dytë):

- a) Për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat fillore të Komunës së Vushtrrisë.
- b) Për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të ulëta të Komunës së Vushtrrisë.
- c) Për organizimin e punës dhe mësimit në shkollat e mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë.

Musaj Tërbunja, drejtor i DA-së - njoftoi për një lëshim teknik në thirrjet juridike në të tri draft-rregulloret në fjalë, i cili do të korrigjohet pas aprovimit të tyre.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit- duke iu referuar Rregullores për shkollat fillore, propozoi: te neni 3 të riformulohet fjalia: "mësuesit e specializuar në vend të lëndës së matematikës, duhet të jenë mësues të specializuar në lëndët edukatë fizike dhe edukatë muzikore"; neni 4.8 propozoi t'i shtohet fjalia: "numri i nxënësve nëpër paralele të jetë 20 – 25 nxënës"; neni 4.2 të riformulohet kështu: "nxënësi nën moshën 6 vjeçare të mos regjistrohet në klasën e I-rë"; neni 4.4 t'i shtohet fjalia: "nëse fëmija nuk tregon aftësi psiko-fizike, edhe pse ka mbushur moshën 6 vjeçare, të mos regjistrohet deri në vitin e ardhshëm shkollor"; neni 8.5 t'i shtohet edhe kjo fjali: "ndërrimin e klasës apo shkollës"; neni 10.3 t'i shtohet edhe kjo fjali: "prindi që nuk interesohet për fëmijën e tij, t'i merret fëmija nga përkujdesi prindëror dhe të dërgohet në institucionet përkatëse për përkujdesje të fëmijëve".

Melihate Basholli, anëtare e kuvendit- e mbështeti propozimin e S.Sylës lidhur me caktimin e numrit të nxënësve nëpër paralele, që maksimumi të jetë 25 nxënës. Po ashtu te Draft-rregullorja për shkollat e mesme të ulëta, te neni 7.2 (si dhe në nenet tjera të rregulloreve në fjalë) propozoi që shprehja "mungesat e nxënësit" të zëvendësohet me shprehjen "vijueshmëri", pasi që ka nxënës që nuk ka mungesa fare.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit- duke iu referuar Rregullores për shkollat e mesme të larta, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi me sa vijon: lidhur me nënparagrafin 8.1.5 pyeti se çka do të ndodh pas pezullimit të përkohshëm prej 1-3 muaj, si dhe çka nënkuptohet me mësime alternativ, kush e organizon mësimin alternativ,

si do të mbahet dhe kush do ta financon, duke shtuar se drejtori i shkollës e njofton DA-në për mësimin alternativ, por nuk saktësohet se kush e bart barrën e financimit. Lidhur me nenin 16.6 pyeti se sa do të zbatohet masa disiplinore ndaj mësimdhënësve që organizojnë kurse private, duke shtuar se për moszbatim të kësaj rregulloreje, përgjegjësinë e mban DA-ja; te neni 24.7 propozoi që të hiqet fjalia: “në mungesë të hapësirës së nevojshme me pëlqimin e DA-së mund të organizohet edhe jashtë komunës”; neni 24.8 propozoi që t’i shtohet edhe kjo fjali: “në mbrëmje të maturës të marrin pjesë vetëm mësimdhënësit dhe personeli i shkollës përkatëse”; neni 24.19.9 kërkoi që të hiqet, pasi që në ekskursion janë prezent drejtori, zëvendës drejtori dhe këshilli organizativ.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar tri draft-rregulloreve, ku flitet për përzedhjen dhe shpërblimin e mësimdhënësit më të mirë në nivel të komunës, propozoi që mësimdhënësi i tillë të shpërblehet me shumën prej 20 % të pagës bazë. Po ashtu propozoi që tri draft-rregulloreve t’u shtohet çmimi i ri “Shaban Jashari”, të cilin e ndan MASHT-i. Te neni 20 propozoi t’i shtohet që te shkollat profesionale përveç Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, të ceket edhe Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Shkollat e Mesme.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar Draft-rregulloreve për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, propozoi që të hiqet neni 6.8, me arsyetimin se është i tejkaluar. Pastaj për Draft-rregulloren për shkollat e mesme të ulëta, te neni 11 propozoi që të shtohet një aline e re me këtë përmbajtje: “kujdestari i klasës mban kontakte me prindin e çdo nxënësi (edhe përmes telefonit) për të përcjellë suksesin në mësim dhe disiplinën e nxënësit”.

Fakete Dushi, anëtare e kuvendit - propozoi që të ndahet buxhet për dhënien e mirënjohjeve dhe bursave për nxënësit që kanë talent për të shkruar poezi dhe ese. Pastaj tha se mësimdhënësit po i kushtëzojnë nxënësit në notim me vijueshmërinë në kurset e tyre private. Te neni 7.13 propozoi që fjala “e tepruar” të hiqet, pasi që grimimi për nxënëset në shkolla të ndalohet tërësisht.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - propozoi që për nxënësit me aftësi të kufizuara të angazhohet një mësimdhënësi i veçantë apo asistente krahas mësimdhënësit duke pasur bashkëpunim të ngushtë mes vete.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - lidhur me tri draft-rregulloret në fjalë, ku flitet për masat disiplinore ndaj mësimdhënësve, shuma prej 5 € propozoi që të jetë më e lartë se kaq, duke propozuar që shuma e masës disiplinore për mungesë në një mbledhje në shkollë të jetë ekuivalente me mungesën në orën mësimore.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - lidhur me tri draft-rregulloret në fjalë, ku flitet për masat disiplinore ndaj mësimdhënësve, shuma prej 5 € propozoi që të jetë më e ulët se kaq, duke propozuar që shqiptimi i masës disiplinore të jetë në proporcion me pagën.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit - lidhur me tri draft-rregulloret në fjalë, ku flitet për masat disiplinore ndaj nxënësve, paraqiti mospajtimin e tij me arsyetimin se pezullimi prej tre muajve nga procesi mësimor është humbje e madhe, duke shtuar se në raste të tilla faktor është edhe prindi që nuk punon me fëmijën e tij, prandaj propozoi që në vend të masës së pezullimit prej tre muajve, t’i ndërrohet shkolla në të njëjtin nivel, dhe të transferohet në qytete tjera.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohen tri Rregulloret për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta të Komunës së Vushtrrisë, duke inkorporuar në to edhe ato vërejtje dhe propozime të anëtarëve të kuvendit, të cilat janë në harmoni me legjislacionin në fuqi për fushën e arsimit.

4. Shqyrtimi i Draft-Planit komunal i veprimit për eficiencë të energjisë për periudhën 2014-2020 (shqyrtimi i dytë).

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-planit në fjalë, tha se nuk e din arsyen pse nuk ka pasur reagime nga qytetarët gjatë diskutimit publik, pasi që draft-planin në fjalë si dokument ka një rëndësi të veçantë për interesin e komunës dhe qytetarët e saj. Pastaj tha se dokumenti në fjalë paraqet shumë të dhëna që janë me rëndësi, që deri më tani nuk kanë qenë të rregulluara në këtë mënyrë. Po ashtu tha se në bazë të legjislacionit në fuqi parashihet që të jetë ekipi i trajnuar dhe të raportohet katër herë në vit lidhur me eficiencën e energjisë në komunë. Mandej tha se dokumenti në fjalë në raste të caktuara është kundërthënës, dhe kjo kundërthënie është prezente tek pika 4.1 dhe 4.2. Në fund tha se është shqetësuese nëse analizohen shpenzimet e energjisë elektrike tek institucionet e arsimit, ku ka dallime të mëdha në mes të një shkolle me sipërfaqe më të vogël, e cila ka shpenzuar rrymë më shumë se një shkolle me sipërfaqe më të madhe, duke shtuar se i njëjti problem qëndron edhe në institucionet tjera publike në Komunën e Vushtrisë, prandaj është e domosdoshme që të merren masa konkrete, duke themeluar një ekip komunal të eficiencës, i cili do të përcjellë këto mospërputhje të shpenzimeve të energjisë elektrike. Në fund tha se shumica e paraparë për projekte dhe plane investuese prej 192.000 € për periudhën 2014-2020 është shumë tepër e vogël.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-planit në fjalë, te "ndërtesat e nënsektorit të arsimit", tha se janë paraqitur shumë shkolla që nuk kanë ngrohje, prandaj pyeti se si të njëjtat shkolla kanë shpenzuar rrymë për ngrohje.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota "për" 7 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani komunal i veprimit për eficiencë të energjisë për periudhën 2014-2020.

5. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt: prill, maj dhe qershor 2014.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - tha se pasi që Grupi kuvendar i LDK-së kërkoi që të hiqet kjo pikë e rendit të ditës, e për të cilën nuk do të marrë pjesë fare në diskutim.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se Grupi kuvendar i LVV-së nuk do të marrë pjesë në diskutim për raportin në fjalë.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit - kërkoi që raporti në fjalë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KK-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 23 vota "për" 12 "abstenim" vendosi me sa vijon:

Raporti në fjalë shtyhet për mbledhjen e radhës së KK-së për shqyrtim dhe aprovim, duke e obliguar hartuesin e tij për ta përgatitur dhe prezantuar konform mënyrës së paraparë me ligjin përkatës.

6. Njoftimi i anëtarëve të KK-së lidhur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të komunës për vitin 2013.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se neglizhenca dhe mosinkasimi i të hyrave vetanake ka qenë vërejtje që është dhënë edhe për vitin e kaluar dhe është rekomandim edhe për këtë vit, sepse edhe pse ka një ngritje prej 4 %, përsëri inkasimi është 74 %, prandaj kërkoi një mobilizim më të madh, si dhe ndarjen e inkasimit sipas viteve, pasi që ka shumë borxhe që janë nga vitet paraprake, por ka edhe borxhe diskutabile, duke shtuar se borxhet e këqija janë mbi 2

milione e 500 mijë euro të painkasuara nga tatimi në pronë dhe nga taksa në firmë, dhe nëse të njëjtat nuk inkasohen sa më shpejtë, atëherë është rrezik të pamundësohet inkasimi i tyre, prandaj është e nevojshme të zbatohen në tërësi vërejtjet dhe rekomandimet që janë dhënë nga auditori. Po ashtu tha se mungon plani i veprimit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm për zbatimin e rekomandimeve. Pastaj kërkoi që vërejtjet e dhëna nga auditori të mos përsëriten në vitet tjera vijuese. Në fund kërkoi që të ketë një pasqyrë të detajuar për të gjitha borxhet.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se ka vërejtje tek evidentimi i pasurisë së komunës, për të cilën ka marrë përgjigje se nuk është dorëzuar dokumentacioni për investimet që janë bërë nga institucionet qendrore, por në raportin në fjalë ka vërejtje edhe për vetura zyrtare të paregjistruara, duke shtuar se për këtë të fundit nuk ka pasur asnjë pengesë për t'u evidentuar pasuria e komunës. Pastaj tha se është shqetësuese vërejtja e dhënë tek dobësitë e kontrollit në menaxhmentin e lartë, ku thuhet se nuk funksionojnë procedurat e raportimit të menaxhmenti i lartë të kryetari dhe vartësit e tij dhe si pasojë nuk ka pasur raportime të rregullta dhe të plota të kontrollit të nivelit të lartë, prandaj kryetari i komunës e ka për obligim që në bashkëpunim me vartësit e tij të hartojë një plan të veprimit për t'i implementuar për një periudhë të caktuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga auditori. Në fund tha se Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk ka bërë një plan konkret për implementimin e rekomandimeve të auditorit.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime shtesë, njëkohësisht iu përgjigj edhe vërejtjeve të paraqitura nga ana e anëtarëve të kuvendit për raportin në fjalë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar raportit në fjalë, tha se theksimin e çështjeve apo rekomandimet e dhëna nga auditori i ka marrë me shumë seriozitet dhe do të punohet me shumë përkushtim për mospërsëritjen e rekomandimeve në vitet vijuese, duke i implementuar në tërësi rekomandimet e paraqitura nga auditori. Po ashtu tha se çështja më e rëndësishme që është duke ndodhur është menaxhimi i mirë i buxhetit, duke mos pasur suficit buxhetor. Në fund tha është duke punuar në veçanti për rritjen e inkasimit më të madh të të hyrave vetanake, si dhe prioritet do të jetë regjistrimi i tërë pasurisë së komunës, duke njoftuar se ka formuar një komision të veçantë për evidentimin e pasurisë së komunës.

7. Shqyrtimi i informatës lidhur me përfundimin e gjysmëvjetorit të dytë në shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Vushtrrisë.

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit - e përgëzoi drejtorin e DA-së që në informatën në fjalë i ka inkorporuar të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të KPF-së.

Selvete Sholla, anëtare e kuvendit - e përgëzoi drejtorin e DA-së për paraqitjen e një informate shumë të kompletuar. Pastaj tha se është një brengë e përgjithshme lidhur me rezultatin e testit të maturës, pasi që në Shkollën e mesme teknike është 13 %, kurse në Shkollën e mesme profesionale është 24 %, prandaj Grupi kuvendar i LDK-së kërkon nga DA-ja që të apelojë në instancat më të larta të arsimit që edhe testi i parë i maturës t'i përshtatet shkollave përkatëse adekuate.

Syzana Sylja, anëtare e kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, për nivelin parashkollor, tha se prindërit kanë ngritur shqetësimin pse në shkollën fillore "Naim Frashëri" nuk ka paralele të parashkollorëve, prandaj prindërit e nxënësve kërkojnë që të bëhet hapja e paraleles në shkollën në fjalë, pasi që në të gjitha shkollat tjera ka paralele të tilla.

Habib Mustafa, anëtar i kuvendit - lidhur me informatën në fjalë, tha se është dashtë të paraqitet nga një tabelar për shkollat fillore, shkollat e mesme të ulëta, për gjimnazin dhe për shkollat teknike, në mënyrë që edhe anëtarët e kuvendit ta kenë më të lehtë informimin.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit - njoftoi se është duke u finalizuar Ligji për testin e maturës, i cili rregullon të gjitha specifikat e testit të maturës.

8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjat deri më 25.08.2014.

9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit mbi ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kriterëve të ndarjes së mjeteve financiare nga fondi për transfere dhe subvencione për ndihmë momentale entiteteve publike dhe jopublike në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjat deri më 25.08.2014.

10. Shqyrtimi i Draft-Statutit të Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-Statuti i Teatrit të Qytetit të Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjat deri më 25.08.2014.

11. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 (shqyrtimi i parë).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Tatimin në Pronën e Paluajtshme për vitin 2015 në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Diskutimi publik fillon nga data 01.08.2014 dhe zgjat deri më 25.08.2014.

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpërndarjen e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - lidhur me propozim-vendimin në fjalë, tha se duke e marrë parasysh rëndësinë se për hir të kujt mbahet turniri dhe pjesëmarrjen ndërkombëtare në të, propozoi që shumës prej 2.000 € t'i shtohen edhe 500 €.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim mjetet buxhetore të komunës – fondi për transfere dhe subvencione për aktivitete kulturore, rinore dhe sportive për vitin 2014, nga vlera totale 29,375.00 €, të shfrytëzohen 2,000.00 € (dy mijë euro) për subvencionimin e Turneut Tradicional Memorial në Hendboll.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarje të mjeteve financiare nga buxheti i komunës – fondi për transfere dhe subvencione.


Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndahen mjete financiare në shumën prej 2,000.00 € (dy mijë euro) nga buxheti i komunës – kategoria transfere dhe subvencione të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, nënkategoria “subvencione për raste sociale” – pjesëmarrje në financim të ndërtimit të shtëpisë për banim për znj. Fetije Gërguri nga Vushtrria.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Procesmbajtësi



Alban Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit



Shpëtim Zhegrova